

4. Aspektet specifike për LGBTI

4.1 Çfarë të dhënash duhet të jap për identitetin dhe seksualitetin tim?

Refugjatët/et LGBTI duhet ptjetër të thonë orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor në procedurën e azilit. Për ta bërë këtë, ata duhet t'u përgjigjen gjithashtu pyetjeve rreth jetës së tyre private, procesit të vetëzbulimit dhe marrëdhënieve të tyre deri më sot. Por pyetjet rreth praktikave seksuale janë të ndaluara. Fotografitë dhe videot me përmbajtje seksuale nuk do të pranohen si dëshmi. Edhe këtu ju mbështetin pikat e këshillimit për LGBTI.

4.2 Çfarë mund të bëj nëse në procedurën e azilit nuk e kam thënë hapur seksualitetin ose identitetin tim gjinor?

Zakonisht nuk ka shanse për një seancë të re dëgjimore ku pas një vendimi negativ të mund të shtosh arsye të tjera për arratisjen. Prandaj, është e rëndësishme të përmendni që në fillim orientimin tuaj seksual ose identitetin gjinor si arsye për arratisjen. Personat LGBTI që nuk e kanë bërë këtë nga frika apo turpi, pas një procesi negativ mund të përpiqen të paraqesin një kërkesë të dytëpërmes një avokati ose avokateje.

4.3 A marr azil nëse nuk kam jetuar hapur në atdheun tim?

Refugjatët LGBTI që nuk kanë jetuar hapur në atdhe dhe për këtë arsye janë larguar pa patur persekutime, mund të marrin azil vetëm nëse e kanë bërë këtë gjë nga frika e persekutimit. Nëse ata kanë jetuar fshehurazi për të mos u turpëruar ose për të mbrojtur nderin e familjes, kjo zakonisht nuk është arsye për azil. Atëherë shpesh supozohet se ata/ato mund të jetojnë kështu edhe më tej dhe se nuk ka gjasa për persekutim. Refugjatë homoseksualë të martuar duhet të bëjnë të qartë se pse janë të martuar.

4.4 A është diskriminimi ndaj LGBTI një arsye për azil?

Fyerjet, kërcënimet abstrakte dhe qëndrimet homofobike ose antitrans të shoqërisë së pëgjithshme nuk janë arsye për azil. Megjithatë, nëse diskriminimi në vendin e origjinës është aq masiv saqë përbën një shkelje serioze të të drejtave të njeriut, kjo është arsye për azil. Prandaj, personat LGBTI duhet t'i thonë të gjitha përvojat e diskriminimit dhe dhunës në vendin e origjinës gjatë seancës dëgjimore.

Fluchtgrund: queer - Queer Refugees Deutschland

Projekti LSVD "Fluchtgrund queer - Queer Refugees Deutschland" këshillon, mbështet, krijon kontakte dhe informon refugjatët/et LGBTI dhe organizatat që punojnë me refugjatët/et LGBTI.

Ne ofrojmë:

- Këshillim për refugjatët/et LGBTI dhe i referojmë tek pikat e kontaktit lokal
- Trajnim të qendrave të akomodimit, qendrave të këshillimit, shërbimeve gjuhësore dhe autoriteteve
- Informacion (nëpërmjet faqes së internetit dhe dërgimit të fletushkave dhe posterave)

Për më shumë informacion dhe kontakte me pikat e kontaktit lokal:



www.queer-refugees.de



queer-refugees@lsvd.de



0049/ 157 30961018

Kontakt:

Lilith Raza

(Gjuhët: Gjermanisht, Punjabi, Anglisht, Urdu, Hindi)

☎ 0221 92 59 61-17

Ina Wolf

(Gjuhët: Gjermanisht, Anglisht)

☎ 0221 92 59 61-20

Colin Cahill-Müller

(Gjuhët: Gjermanisht, Anglisht)

☎ 0157 3096 1018

Udhëzues për refugjatët/et lezbike, homoseksualë, biseksualë, transgjitorë dhe interseks (LGBTI) në Gjermani



Albanisch

- Shpjegimi i procedurës së azilit
- Informacion për refugjatët/et LGBTI
- Kontakti me organizatat LGBTI



FLUCHTGRUND:
QUEER
- QUEER REFUGEES DEUTSCHLAND

ein Projekt des

LSVD
Verband Queere Vielfalt

gefördert durch

Die Beauftragte der Bundesregierung
für Migration, Flüchtlinge und Integration
Die Beauftragte der Bundesregierung für Antirassismus

1. Mbrojtja për refugjatët/et LGBTI në Gjermani

1.1 Kur u jepet LGBTI-ve azil në Gjermani?

Nëse dikush është lezbike, homoseksuale, biseksuale, transgjinorë ose interseks (LGBTI) dhe persekutohet, kjo është një kërkesë që njihet për dhënien e azilit në Gjermani. Persekutim do të thotë se në atdhe atyre u kanoset dhuna masive, vdekja, burgosja ose forma të tjera të trajtimit çnjerëzor për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor. LGBTI nuk është tabu në Gjermani. Ju mund dhe duhet të flisni hapur për këtë në procedurën e azilit.

1.2 Kur është përndjekja e shtetit një arsye për marrje azili?

Veprimet persekutuese ose diskriminimet, për shkak të natyrës ose përsëritjes së tyre, duhet të jenë aq serioze sa të përbëjnë një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Vetëm fakti se aktet homoseksuale janë të dënueshme nuk përbën një veprim persekutues. Vetëm imponimi aktual i dënimeve e bën këtë një akt persekutues.

1.3 Kur është persekutimi familjar një arsye për azil? (persekutimi jo shtetëror)

Nëse persekutuesi nuk është shteti (policia, gjyqësori, etj.), por një aktor jo shtetëror (milicia, familja, etj.), atëherë persekutimi do të jetë bazë për azil nëse shteti nuk mund ose nuk do që të ofrojë mbrojtje dhe për këtë ka prova. Pra, dhuna dhe kërcënimet e dhunës nga ana e familjes janë arsye për azil vetëm kur bëhet e qartë se as policia, as zhvendosja në një pjesë tjetër të vendit nuk do të siguronin mbrojtje.

1.4 Ku do të banoj gjatë procedurës së azilit?

Pas paraqitjes së kërkesës për azil, do t'ju caktohet shpërndarja në një nga landët federale. Fillimisht, gjatë procedurës së azilit, strehimi do të jetë në qendrat kolektive. Refugjatët/et aty mund të flasin në mënyrë konfidenciale për nevojat e tyre të veçantë për mbrojtje dhe probleme. Si rregull, vetëm pas vendimit pozitiv të azilit refugjatëve/eve u caktohet një komunë, dhe atyre u lejohet të marrin një apartament privat, të marrin pjesë në një kurs integrimi dhe të punojnë.

2. Procedura e azilit

2.1 Si funksionon procedura e azilit?

Aplikimi për azil mund të kryhet vetëm brenda Gjermanisë. Procedura e azilit zakonisht përfshin dy seanca dëgjimore nga autoriteti i azilit BAMF. Qëllimi i seancës së parë është kryesisht që të qartësojë se cili shtet i Dublinit është përgjegjës. Shtetet e Dublinit janë të gjitha vendet e BE-së, si dhe aktualisht edhe Islanda, Norvegjia, Lishtenshtajni dhe Zvicra. Vetëm seanca e dytë ka të bëjë me arsyet e arratisjes. Punjonësit e BAMF janë subjekt i konfidencialitetit ligjor.

2.2 Çfarë duhet të bëj para seancave dëgjimore?

Për përgatitje këshillohet që të kërkohet asistencë nga këshillimet për procedurat e azilit dhe pikat e kontaktit për refugjatët/et LGBTI. Është mirë që të shënoni kronologjikisht të gjitha veprimet persekutuese, të mblidhni evidencat dhe të praktikoni se si do flisni për atë që keni përjetuar. Gjithashtu është e këshillueshme që nëpërmjet emailit të kërkonti sa më herët një dëgjues/e të trajnuar për personat LGBTI dhe të njoftoni për një shoqërues/e.

2.3 Çfarë ndodh në seancën e parë dëgjimore? (Sistemi i Dublinit)

Seanca e parë përfshin kryesisht pyetje rreth personit, qëndrimin të familjes dhe rrugës së arratisjes. Parimisht, përgjegjës për procedurën e azilit është shteti i cili ka lëshuar vizën e hyrjes. Nëse dikush udhëton pa vizë, përgjegjës është shteti i Dublinit ku personi ka hyrë për herë të parë. Zakonisht ky person ridërgohet atje.

2.4 Çfarë ndodh në seancën e dytë dëgjimore? (Arsyet e arratisjes)

Seanca e dytë ka të bëjë me arsyet e arratisjes. Këto duhet të përshkruhen pa boshllëqe, pa kontradikta, në një mënyrë konkrete, të qartë dhe të detajuara. Gënjeshtrat në seancë zakonisht dallohen nga BAMF dhe çojnë në një refuzim. Në fund bëhet një ripërkthim i protokollit, i cili pastaj vërtetohet përmes nënshkrimit. Për këtë arsye duhet të insistohet që të gjitha problemet gjatë seancës dëgjimore të vihen në procesverbal.

3. Llojet e mbrojtjes dhe mundësia e padisë

3.1 Cilat lloje të mbrojtjes ndërkombëtare ekzistojnë?

Azil klasik (fillimisht për 3 vjet) marrin kryesisht të persekutuuarit/at politikë që kanë hyrë me fluturime direkte në Gjermani. Ndërsa, personat e persekutuuar që kanë hyrë nëpërmjet një vendi tjetër të BE-së, marrin status refugjati, nëse u jepet (po për 3 vjet). Refugjatët/et e luftës civile zakonisht marrin mbrojtje shtesë (fillimisht 1 vit). Nëse arsyet për azil për secilin rast vazhdojnë të ekzistojnë, statusi do të zgjatet.

3.2 Çfarë duhet të kenë parasysh refugjatët/et LGBTI nga vendet e luftës civile?

Edhe refugjatët/et LGBTI nga vendet e luftës civile duhet të përmendin patjetër gjatë procedurës së azilit diskriminimin dhe persekutimin që kanë përjetuar si rezultat i orientimit seksual ose identitetit gjinor. Kështu ekziston një shans për të marrë një status mbrojtës trevjeçar, i cili është i pavarur nga lufta civile. Përmendja e mëvonshme e këtyre arsyeve është më e vështirë.

3.3 Çfarë mund të bëj nëse marr një vendim negativ?

Një vendim negativ nuk do të thotë domosdoshmërisht largim nga vendi. Në çdo rast, është e mundur që nëpërmjet një avokati/teje të ngritët padi kundër vendimit negativ. Edhe në qoftë se padia dështon, në shumë raste, për arsye të ndryshme, nuk bëhet dëbimi. Prandaj, shpesh është mirë të kontrollosh nëse ka pengesa dëbimi, përkundër aplikimit për azil.

3.4 Cilat janë procedurat e përshpejtuara?

Procedurat e përshpejtuara kryhen me refugjatë nga të ashtuquajturat vende të sigurta të origjinës (të gjitha vendet e BE-së, si dhe aktualisht të gjithë shtetet e Ballkanit, Gana dhe Senegali). Edhe të gjithë refugjatët/et që kanë mashtruar në mënyrë të dukshme për identitetin e tyre ose që kanë shkatërruar dokumentet e tyre futen në procesin e përshpejtuar. Në këto procedura autoriteti i azilit fillimisht nisët nga ajo që nuk ekzistojnë arsye për azil. Prandaj, fillimisht këto kërkesa refuzohen si "dukshëm të pabazuara".